



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 20 dhe 21 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-029 për Patenta.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Besian Mustafa, emërohet Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë për investime dhe perkrahjen e ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/25

Datë: 29.04.2015

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, mori:

V E N D I M

Për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik për nënshkrimin e Marrëveshjes në mes Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim: "KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë në rajonin e Mitrovicës"

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik për nënshkrimin e Marrëveshjes në mes Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim: "KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë në rajonin e Mitrovicës"
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës së Madhe të Luksemburgut për "Projektin e bashkëpunimit për zhvillim: "KSV/017: Programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë (Pjesa II).
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që të zhvilloj negociata me Qeverinë e Dukës së Madhe të Luksemburgut, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:


V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Qeverisë nr. 07/134, i datës 17.06.2013 për themelimin e Këshillit Ndërministror për Kontrollin e Duhanit

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë nr. 07/134, i datës 17.06.2013 për themelimin e Këshillit Ndërministror për Kontrollin e Duhanit si në vijim:
 - 1.1. Ministri i Shëndetësisë, Kryesues;
 - 1.2. Ministria e Financave, anëtar;
 - 1.3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar;
 - 1.4. Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 1.5. Ministria e Drejtësisë, anëtar;
 - 1.6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
 - 1.7. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar;
 - 1.8. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, anëtar;
 - 1.9. Ministria e Infrastrukturës, anëtar;
 - 1.10. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 1.11. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, anëtar;
 - 1.12. Përfaqësuesi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë; anëtar;
 - 1.13. Përfaqësuesi i Qendrës Kosovare për Avokim dhe Zhvillim, anëtar;
 - 1.14. Përfaqësuesi i Asociacionit për të Drejtat e Pacienteve, anëtar;
 - 1.15. Përfaqësuesi i Organizatës "Konsumatori", anëtar;
 - 1.16. Përfaqësuesi nga Mjetet e Informimit Publik, anëtar;
 - 1.17. Koordinatorin Nacional për Kontroll të Duhanit, anëtar.
2. Të gjithë Kryeinspektorët e inspektorateve të përmendura në ligj janë anëtar të Këshillit Ndërministror sipas funksionit në cilësinë e ekspertëve.
3. Këshilli detyrat e tij i kryen konform nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë nr. 08/141, i datës 26.07.2013 për themelimin e Këshillit Ndërmintor për luftimin dhe parandalimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo në Kosovë

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë nr. 08/141, i datës 26.07.2013 për themelimin e Këshillit Ndërmintor për luftimin dhe parandalimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo në Kosovë me qëllim të sigurimit dhe mbikëqyrjes dhe monitorimit të vazhduar të zbatimit të plotë të Strategjisë së Etheve Hemorragjike Krime Kongo në Kosovë si në vijim:
 - 1.1. Ministri, Ministria e Shëndetësisë, Kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Klinika Infektive, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, anëtar;
 - 1.6. Përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar;
 - 1.7. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 1.8. Përfaqësues nga Ministria e Financave, anëtar;
 - 1.9. Përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 1.10. Përfaqësues nga Ministria e Forcës së Sigurisë, anëtar.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, 04/L-165, 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2016-2018.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Kornizën nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenin 6 paragrafi 6.2 pika (h) të plotësim ndryshimit të Ligjit Nr. 04/L-194 dhe nenit 8 të Ligji nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor për Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Tremujor i Buxhetit për vitin 2015.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Kosovës konform kërkesave të nenit 45 të Ligjit 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/25
Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-175 për Borxhet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi i Borxhit Shtetëror për vitet 2016-2018.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për njoftim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të Ndërmarrjeve Shoqërore "Auto Moto Kosova" dhe "INA Zagreb" të cilat preken nga ndërtimi i Objekteve Ndërtimore për nevoja të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme /Ministria e Financave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik me krijimin e të drejtës së servitutit i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Linjës Energjetike 400kV Kosovë-Shqipëri, Segmenti III-tretë 45 km, Zonat Kadastrale, Pastasellë, Pollozhë, Dubidol, Zatriq, Qifllak dhe Rahovec të Komunës së Rahovecit, Zona Kadastrale Gramaqel, Komuna Deçan, Zona Kadastrale Junik, Komuna Junik dhe Zonat Kadastrale Dubiqare, Meqë, Bec, Kodrali, Zhdrellë, Janosh, Palabardh, Novosellë e Epërme, Dobrixhë, Hereq, Sheremet, Nivokaz, Batushë, Molliq, dhe Brovinë të Komunës së Gjakovës, sipas tabelave bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Kompania Publike "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" Sh.A. (KOSTT) do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik me krijimin e të drejtës së servitutit i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Segmentit Rrugor 7.3 që lidhë Autostradën Vërmicë-Merdare R7, Autoudhën R6 Prishtinë-Han i Elezit dhe Rrugën Magjistrale M2, Zonat Kadastrale Qagllavicë, Komuna e Prishtinës dhe Uglar, Komuna e Graçanicës, sipas tabelave bashkangjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.
6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.

7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Fabrikës së riciklimit dhe përpunimit të nën-produkteve shtazore, Zona Kadastrale Sankoc, Komuna Gillogoc, sipas tabelave të bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet sipas kategorive përkatëse nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme / Ministria e Financave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/25

Datë: 29.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, 04/L-165, 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 210,677 (dyqinddhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjeteshtatë) euro për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nën-programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 131 dhe barten në OB me kod 250 Prokurori i Shtetit, nën-programi Prokurorët special, me kod 322, kategoria ekonomike paga dhe mëditje.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Prokurori i Shtetit - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë